


LegalNews

May 2022
Maj 2022

SPECIAL



Deloitte.

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 328, datë 18.05.2022 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 1088, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e mënyrës dhe të procedurave të regjistrimit e publikimit të të dhënave për pronarët përfitues, si dhe njoftimit nga autoritetet shtetërore kompetente dhe nga subjektet e detyruara" të ndryshuar.

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, më datë 18.05.2022, ka miratuar Vendimin nr. 328, datë 18.05.2022 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 1088, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, 'Për përcaktimin e mënyrës dhe të procedurave të regjistrimit e publikimit të të dhënave për pronarët përfitues, si dhe të njoftimit nga autoritetet shtetërore kompetente dhe nga subjektet e detyruara', të ndryshuar" (në vijim "**Vendimi**").

Vendimi saktëson, qartëson dhe riformulon disa aspekte të caktuara të procedurave të regjistrimit të të dhënave të pronarëve përfitues, në përputhje me ndryshimet e Ligjit nr. 6/2022 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 112/2020 " Për Regjistrin e Pronarëve Përfitues", i ndryshuar (në vijim "**Ligji për RPP**").

Vendimi, ndër të tjera :

- Përkufizon regjistrimin fillestar si regjistrimi për herë të parë i pronarëve përfitues të subjekteve raportuese, në përputhje me parashikimet e Ligjit për RPP;

Decision of the Council of Ministers no. 328, dated 18.05.2022 "On some additions and amendments to the Decision no. 1088, dated 24.12.2020, of the Council of Ministers, "On determining the manner and procedures of registration and publication of data on ultimate beneficial owners, as well as notification by the competent state authorities and by compulsory entities" as amended.

The Council of Ministers of the Republic of Albania, on 18.05.2022, has approved Decision no. 328, dated 18.05.2022 "On some additions and amendments to Decision no. 1088, dated 24.12.2020, of the Council of Ministers, 'On determining the manner and procedures of registration and publication of data on ultimate beneficial owners, as well as notification by the competent state authorities and by compulsory entities', as amended" ("hereinafter **Decision**").

The Decision clarifies and reformulates certain aspects of the data registration procedures on the ultimate beneficial owners, in accordance with the amendments of the Law no. 6/2022 "On some changes and additions to Law no. 112/2020 "On the Register of Ultimate Beneficial Owners", as amended ("**RBO Law**").

The Decision, inter alia:

- Defines the initial registration as the first registration of the ultimate beneficial owners of reporting legal entities, in accordance with the provisions of the RBO Law;

- Përkufizon regjistrimin e ndryshimeve si regjistrimi i çdo ndryshimi faktik të personit të regjistruar më parë si pronar përfitues, sipas Ligjit për RPP (zëvendësimi, shtimi i një personi të ri apo heqja e një personi nga Regjistri i Pronarëve Përfitues), si dhe regjistrimi i çdo ndryshimi tjetër në të dhënat e regjistruara të pronarëve përfitues;
- Përcakton se kërkesa për regjistrimin fillestar të pronarëve përfitues të subjekteve raportuese, që regjistrohen në regjistrin tregtar, paraqitet nga personi i autorizuar për të përfaqësuar subjektin raportues, sipas procedurave të parashikuara nga legjislacioni që rregullon procedurat e regjistrimit fillestar të personit juridik në regjistrin tregtar;
- Përcakton se deklarata me shkrim e nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor i subjektit raportues, e cila përcakton hapat e ndërmarrë për identifikimin e pronarit përfitueskur subjektet raportuese nuk arrijnë të identifikojnë si pronar përfitues individin i cili ka në pronësi ose kontrollon i fundit një person juridik, përmes pronësisë direkte ose indirekte të 25% ose më tepër të aksioneve/kuotave të kapitalit ose të interesave të pronësisë në një subjekt raportues sipas përcaktimeve të ligjit, duhet të jetë hartuar brenda **90 ditëve** nga data e regjistrimit fillestar apo ndodhjes së ndryshimit faktik.
- Defines the registration of changes as the registration of any factual change of the individual previously registered as an ultimate beneficial owner, according to the RBO Law (replacement, addition of a new individual or removal of an individual from the Register of Ultimate Beneficial Owners), as well as registration of any other change in the registered records of the ultimate beneficial owners;
- Determines that the request for initial registration of the ultimate beneficial owners of the reporting entities, registered in the commercial register, is submitted by the person authorized to represent the entity, according to the procedures provided by the legislation governing the procedures of initial registration of legal persons in the commercial register;
- Provides that the written statement signed by the legal representative of the reporting entity, which sets out the steps taken to identify the ultimate beneficial owner, when entities fail to identify as ultimate beneficial owner the individual who owns or ultimately controls a legal entity, through direct or indirect ownership of 25% or more of shares / quotas of capital or ownership interests in a reporting entity as defined by law, must be drafted within **90 days** from the date of initial registration or the occurrence of the actual change.

Në lidhje me procedurën e pezullimit të aplikimit

Vendimi përcakton se kur aplikimi përmban të meta apo pasaktësi:

i. në rastin e një kërkesë për regjistrim fillestar:

- QKB pezullon aplikimin jo më vonë se 1 ditë pune nga marrja e kërkesës, duke pezulluar njëkohësisht edhe pezullimin e procedurave të regjistrimit fillestar të personit juridik në regjistrin tregtar.

Plotësimi i të metave që pengojnë regjistrimin kryhet nga subjekti raportues brenda afateve (21 ditë) të parashikuara nga legjislacioni në fuqi që rregullon procedurat e regjistrimit në regjistrin tregtar.

Mosplotësimi i të metave që pengojnë regjistrimin në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas këtij vendimi, nga subjekti raportues me pronësi direkte përbën shkak për refuzimin e aplikimit për regjistrimin e personit juridik në regjistrin tregtar sipas legjislacionit përkatës.

ii. Në rastin e të gjitha regjistrimeve të tjera,

- QKB pezullon aplikimin jo më vonë se 2 ditë pune nga marrja e kërkesës dhe njofton subjektin raportues për shkakun e saktë të pezullimit.

Regarding the procedure for suspension of applications

The Decision determines that in case the application contains defects or inaccuracies:

i. in case of an initial registration request:

- The National Business Center (hereinafter, "NBC") suspends the application no later than 1 working day from the receipt of the request, suspending at the same time the procedures of initial registration of the legal entity in the commercial register;

The completion of defects that hinder the registration must be performed by the reporting entity within the deadline (21 days) provided by the legislation in force that regulates the registration procedures in the commercial register.

Failure to complete the defects that prevent the registration in the register of ultimate beneficial owners, according to this decision, by the reporting entity with direct ownership, constitutes a reason for the rejection of the application for registration of the legal entity in the commercial register, according to the relevant legislation.

ii. In case of all other registrations

- NBC suspends the application no later than 2 working days from the receipt of the request and notifies the reporting entity about the exact reason for the suspension.

Plotësimi i të metave që pengojnë regjistrimin kryhet nga subjekti raportues brenda 30 ditëve.

Në lidhje me refuzimin e aplikimeve

- Vendimi përcakton se me përfundimin e afateve të përcaktuara si më lart, QKB refuzon aplikimin jo më vonë se 2 ditë pune;
- Vendimi thekson se ri-aplikimi pas refuzimit nuk i çliron subjektet raportuese nga sanksionet në lidhje me moskryerjen e regjistrimeve të detyrueshme brenda afateve ligjore.

Në lidhje me afatet dhe sanksionet

- Vendimi saktëson detyrimin e QKB, për identifikimin e subjekteve raportuese ekzistuese me pronësi direkte të regjistruara në Regjistrin Tregtar , të cilat në datën e hyrjes në fuqi të Ligjit për RPP, nuk kanë përmbushur detyrimin për regjistrimin fillestar të pronarëve të tyre përfitues. Gjithashtu, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit (AKSHI), brenda datës 30.6.2022, QKB, transferon nga baza e të dhënave ekzistuese në Regjistrin Tregtar në regjistrin e pronarëve përfitues të dhënat e pronarëve përfitues të subjekteve si më lart të përcaktuara;
- Vendimi saktëson se subjektet raportuese të regjistruara në Regjistrin Tregtar me pronësi indirekte si dhe subjektet raportuese të regjistruara në Regjistrin e Organizatave Jofitimprurëse, të cilat në datën

Completion of defects that hinder registration must be performed by the reporting entity within 30 days.

Regarding the rejection of applications

- The Decision stipulates that upon missing the deadlines set out above, the NBC rejects the application no later than 2 working days;
- The Decision states that re-application after rejection does not release the reporting entities from the sanctions related to the non-fulfillment of the obligatory registrations within the legal deadlines.

Regarding deadlines and sanctions

- The Decision specifies the obligation of the NBC, to identify existing reporting entities with direct ownership registered in the Commercial Register, which on the date of entry into force of the RBO Law, have not fulfilled the obligation for initial registration of their ultimate beneficial owners. Also, in cooperation with the National Agency for Information Society (NAIS), within 30.6.2022, NBC transfers from the existing database in the Commercial Register to the register of beneficiary owners the data of the beneficial owners of the above mentioned entities;
- The Decision specifies that reporting entities registered in the Commercial Register with indirect ownership as well as reporting entities registered in the Register of Non-Profit Organizations, which on the date of entry into force of

e hyrjes në fuqi të Ligjit për RPP, nuk kanë përmbushur detyrimin për regjistrimin fillestar apo për regjistrimin e ndryshimeve të të dhënave të pronarëve të tyre përfitues, duhet t'i përmbushin këto detyrime brenda datës **30.06.2022**;

- Vendimi saktëson gjobën prej **400 000 lekë** për mospërmbushje të detyrimeve si më lart përcaktuar.

Vendimi ka hyrë në fuqi me publikimin e tij në Fletoren Zyrtare nr. 76, datë 20.05.2022.

the RBO Law, have not fulfilled the obligation for initial registration or data changes registration of their ultimate beneficial owners, must meet these obligations by **30.06.2022**;

- The Decision specifies the fine of **400,000 ALL** for non-fulfillment of obligations as defined above.

The Decision has entered into force immediately after its publication in the Official Gazette no. 76, dated 20.05.2022.

Deloitte Contacts

Olindo Shehu, CPA

Partner | Tax & Legal Services
Deloitte Albania sh.p.k

Rruga e Kavajës, Ish parku i mallrave
Kompleksi Delijorgji, Godina L,
Kati 1, 2 dhe 3
1010, Tirana, Albania
Mob: +355 68 60 33 116
E-mail: oshehu@deloitteCE.com

Sabina Lalaj

Local Legal Partner
Deloitte Legal sh.p.k

Rruga e Kavajës, Ish parku i mallrave
Kompleksi Delijorgji, Godina L,
Kati 1, 2 dhe 3
1010, Tirana, Albania
Mobile: + 355 68 37 33 130
E-mail: slalaj@deloitteCE.com

Disclaimer:

This publication contains general information only, and none of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, any of its member firms or any of the foregoing's affiliates (collectively the "Deloitte Network") are, by means of this publication, rendering accounting, business, financial, investment, legal, tax, or other professional advice or services. This publication is not a substitute for such professional advice or services, nor should it be used as a basis for any decision or action that may affect your finances or your business. Before making any decision or taking any action that may affect your finances or your business, you should consult a

qualified professional adviser. No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

Deloitte refers to one or more of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, a UK private company limited by guarantee, and its network of member firms, each of which is a legally separate and independent entity. Please see www.deloitte.com/al/about for a detailed description of the legal structure of Deloitte Touché Tohmatsu Limited and its member firms. Deloitte provides audit, tax, consulting, and financial advisory services to public and private clients spanning multiple industries. With a globally connected network of member firms in more than 150 countries, Deloitte brings world-class capabilities and deep local expertise to help clients succeed wherever they operate. Deloitte's approximately 312,000 professionals are committed to becoming the standard of excellence.

© 2022 Deloitte Legal sh.p.k